



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr.130/1 Prot.

Tiranë, më 14.01.2026

**V E N D I M**

**Nr. 9, Datë 14.01.2026**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 318, datë 11.12.2025, e paraqitur nga z. I. B., kundër Bashkisë Tiranë, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “racës” dhe “gjendjes ekonomike”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna, ankuesi në mes të tjerash informon se: *Quhem I. B., dhe banoj në Kombinat, në një kontenier të vendosur nga bashkia, së bashku me familjen time. Banesa ime, ku kam jetuar më parë, është bërë e pabanueshme për shkak të dëmtimeve të shkaktuara nga tërmeti dhe në vitin 2019 është kryer vlerësimi i nivelit të dëmit. Jeta në kontenierin ku jetojmë aktualisht është bërë shumë e vështirë. Gjatë këtyre viteve jam interesuar vazhdimisht që rasti im të trajtohej sa më shpejt, me qëllim që të transferoheshim në një strehim tjetër, pasi edhe banesa që kam në pronësi nuk mund të rindërtohej nga bashkia, për shkak se ndodhet pranë një shtylle të tensionit të lartë. Institucionet përkatëse kanë dijeni për gjendjen në të cilën ndodhemi, por deri më sot nuk kanë ndërmarrë veprime konkrete dhe na kanë lënë në harresë.*

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit, zgjidhjen e situatës dhe transferimin në një banesë.

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, në lidhje me shkaqet e pretenduara nga ana e subjektit ankues dhe lidhjen shkakësore ndërmjet trajtimit më pak të favorshëm dhe shkakut të mbrojtur, si dhe në lidhje me mungesën e sqarimit të plotë të mënyrës se si këto shkaqe kanë ndikuar drejtpërdrejt në trajtimin e konsideruar diskriminues. Gjithashtu, ankesa nuk përmbante të dhëna të sakta dhe të plota lidhur

me datën, muajin dhe vitin kur pretendohet se ka ndodhur ngjarja diskriminuese, si dhe datën kur subjekti ankues ka marrë dijeni për këtë situatë, si edhe dokumentacion apo prova mbështetëse që vërtetojnë pretendimet e ngritura.

Për këtë arsye, me shkresën nr. 1747/1 prot., datë 17.12.2025, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i është kërkuar informacioni mëposhtëm:

- Të saktësohen shkaqet e pretenduara për diskriminim. Ky informacion duhet të shoqërohet me fakte dhe prova konkrete që vërtetojnë se ju i mbartni këto shkaqe të pretenduara.
- Përveç përshkrimit të shkaqeve, është e nevojshme të sqarohet në mënyrë të qartë se si këto shkaqe kanë ndikuar drejtpërdrejt në trajtimin që ju konsideroni diskriminues. Ju lutemi të përshkruani lidhjen midis rrethanave të paraqitura dhe pasojave konkrete që keni përjetuar për shkak të tyre.
- Të saktësohet në mënyrë të qartë dhe të plotë datën, muajin dhe vitin kur ka ndodhur ngjarja që pretendoni si diskriminuese, si dhe datën kur keni marrë dijeni për këtë situatë.
- Çdo informacion ose dokumentacion tjetër shtesë që ju do e gjykoni të nevojshëm në mbështetje të ankesës tuaj.

Me shkresën nr. 1747/2 prot., datë 23.12.2025 është administruar pranë Komisionerit, një përgjigje e dërguar nga subjekti, ku shpjegon se: *Në përgjigje të shkresës suaj, sqaroj se diskriminimi për ne rrjedh nga racizmi. Ankohemi për shtëpi, shkojmë tek Bashkia Tiranë, na thonë që nuk përfitojmë. Kjo shtypje ndodh nga racizmi, prandaj kërkoj mbrojtjen tuaj që të na ndihmoni të na japin shtëpi. Në kontenier banojmë shtatë veta dhe jemi familje e madhe. Diskriminimi ynë ka ndodhur në vitin 2021 dhe ne kemi marrë dijeni në vitin 2021 se ky problem atëherë na ndodhi, që ata s'po na ndihmonin më.*

## **II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:**

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, së ndryshuar, garantohet *ndaj çdo veprimi apo mosveprimi* të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët *publikë apo privatë*, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankuesja pranë KMD-së, konstatohet se:

Në ankesën objekt shqyrtimi, z. I. B., pretendon se diskriminohet nga Bashkia Tiranë, për shkak të “racës” dhe “gjendjes ekonomike”.

Në nenin 33, pika 4, gërma dh), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, parashikohet se: *“Ankesa nuk pranohet kur: .... (2) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dëni për sjelljen diskriminuese”*. Parashikimi i sipërcituar nuk është kumulativ dhe kërkon si kriter për mospranimin e ankesës, plotësimin e njërit prej kushteve të mësipërme.

Referuar informacionit të cituar në ankesë dhe materialeve bashkëngjitur saj, rezulton se:

- Subjekti ankues, z. I.B., ka paraqitur kërkesë pranë Bashkisë Tiranë lidhur me përfitimin e strehimit, pas dëmtimit të banesës së tij nga tërmeti 2019. Referuar informacionit të cituar në ankesë, rezulton se diskriminimi i pretenduar ka ndodhur gjatë vitit 2021, fakt i cili është pohuar edhe nga vetë subjekti ankues, ndërsa ai ka marrë dëni për këtë situatë në vitin 2021.

Referuar informacionit të cituar në ankesë, rezulton se data e ndodhjes së diskriminimit të pretenduar është perudha e vitit 2021, kohë në të cilën subjekti ankues pretendon se është trajtuar në mënyrë të pabarabartë nga Bashkia Tiranë lidhur me përfitimin e strehimit. Ky fakt është pohuar edhe nga vetë ankuesi në kthimin e përgjigjes së dërguar pranë Komisionerit. Gjithashtu, kjo periudhë kohore është konfirmuar edhe gjatë takimit të zhvilluar në datën 23.12.2025 pranë zyrave të Komisionerit, ku subjekti ankues ka dhënë sqarime shtesë lidhur me pretendimet e tij.

Për sa më sipër, KMD gjykon se momenti i ndodhjes së diskriminimit të pretenduar është 13.01.2022, kur ankuesi ka bërë kërkesën nr. 95 prot., datë 10.01.2022 drejtuar Njesisë Administrative Vaqarr, për pajisje me leje ndërtimi për objektin që ka në posedim. Ndërkohë që, data e depozitimit të ankesës pranë KMD-së është në datë 11.12.2025. Në këtë kontekst,

Komisioneri gjykon se momenti i ndodhjes së diskriminimit daton më shumë se 3 (vjet) nga ndodhja e diskriminimit të pretenduar. Njëkohësisht, edhe momenti, i marrjes dijeni mbi diskriminimin e pretenduar, daton më vonë se 2 (dy) vjet nga data e depozitimit të ankesës nr. 318, datë 11.12.2025 pranë KMD-së.

Pra, konkludojmë së janë tejkaluar afatet ligjore të përcaktuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>.

Mbështetur në dispozitën e sipërpërmendur, Komisioneri nuk e pranon për shqyrtim ankesën nr. 318, datë 11.12.2025, të z. I. B., pasi është jashtë afateve ligjore për t’u shqyrtuar nga ky institucion.

Sa më sipër, sjellim në vëmendje se ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 34, në pikën 2 të tij, parashikon se: “*Paraqitja e ankimit përpara Komisionerit nuk është kusht për të paraqitur një kërkesëpadi dhe nuk përbën pengesë për personin e dëmtuar t’i drejtohet gjykatës ose organeve të ndjekjes penale*”.

Nga ana tjetër, ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 36, pika 1 të tij, parashikon se: “*Padia i paraqitet gjykatës kompetente nga një prej subjekteve të parashikuara në nenin 34 të këtij ligji jo më vonë se 5 vjet nga dita kur ka ndodhur sjellja e pretenduar diskriminuese dhe jo më vonë se 3 vjet nga dita kur i dëmtuari merr dijeni për këtë sjellje*”.

Duke qenë se subjekti ankues është brenda afateve të parashikuara në këtë Ligj<sup>2</sup>, për të ndjekur gjyqësisht pretendimin e tij për diskriminim, Komisioneri i rekomandon që t’i drejtohet gjykatës kompetente.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “dh” të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I:**

1. Mospranimin e ankesës nr. 318, datë 11.12.2025, të paraqitur nga z. I. B., kundër Bashkisë Tiranë, pasi është paraqitur tej afateve ligjore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

<sup>1</sup> Për analogji shih Vendimet nr. 158, datë 28.05.2024 dhe nr. 56, datë 12.03.2025, të Komisionerit.

<sup>2</sup> Neni 36 i Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar: “Procedura para gjykatës”.